



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 766/5 Prot.

Durrës, më 30.06.2020

**VENDIM**

Nr. 59, datë 30.06 2020

**PËR**

**"KALIMIN KAPITAL TË INVENTARIT TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE TË INTEGRUARA ME PRAKTIKËN NË INVENTARIN E UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS"**

Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik, shkresën nr. 57 prot., datë 15.06.2020 të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën me objekt "Kërkesë për kalimin kapital të inventarit fizik të FASTIP – it, në llogaritë inventariale të UAMD - së", relacionin nr. 276 prot., datë 30.12.2019 të komisionit të kryerjes së inventarit në FASTIP, shkresën nr. 750, datë 26.06.2020 të Administratorit me objekt "Kërkesë për transferim kapital", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.06.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kalimit kapital të inventarit të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën në inventarin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës në vlerën 3 406 183 (tremilion e katërqind e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.
2. Referuar shkresës nr. 57, datë 15.06.2020 të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën vlera e llogarive inventarile të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, do të shtohet si më poshtë:
  - Llogaria 218 në vlerën neto 2 509 203 lekë
  - Llogaria 327 në vlerën neto 896 980 lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
  - Administratori
  - Drejtoria e Administrimit Financiar
  - Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**  
**Ilirjana NANO**

